

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët–Valdete Daka, kryetare, Nesrin Lushta e Avdi Dinaj-anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit Sh. M. nga komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185.par.1.të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.687/2016 të datës 18.07.2016., në seancën e mbajtur më 03.10.2016., mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit Sh. M. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.687/2016 të datës 18.07.2016.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.626/2016 të datës 07.04.2016. i dënuari Sh. M. është shpallur fajtor për veprën penale kanosje nga neni 185.par.1.të KPK dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, në të cilin dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 23.03.2016. deri më datën 07.04.2016. Është obliguar të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe

paushallin gjyqësor ndërsa e dëmtuara për realizimin e kërkesës pronësoro juridike është udhëzuar në kontestin civil.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit e Kosovës PA1.nr.687/2016 të datës 18.07.2016. është refuzuar si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të dënuarit ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë mbrojtësja e të dënuarit, avokatja E. Gj. nga Prizreni, ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, me propozim që të ndryshohet ashtu që i dënuarit të lirohet nga akuza ose të anulohet dhe çështja të kthehet gjykatës së shkallës së dytë në rivendosje.

Prokurori i shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.168/16 të datës 05.09.2016. ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435. par. 1. lidhur me nenin 436. par. 1. të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatojë se:

-kërkesa është e pabazuar.

Pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë kanë të bëjnë me vendimin për sanksionin penal dhe në kërkesë theksohet se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë nuk kanë vlerësuar rrethanat e shumta lehtësuese të cilat tregojnë se ka pas vend për shqiptimin e dënimit më të butë, siç janë se i dënuari ka pranuar fajësinë, ka shprehur pendim për veprën e kryer penale, ka premtuar se veprën nuk do të përsërit, është i moshës së re, vepra penale nuk ka pas pasoja, se është i gjendjes së dobët ekonomike, i papunë, ka pas sjellje të mira në gjykatë, më parë nuk është i gjykuar dhe kundër tij nuk zhvillohet veprë tjetër penale.

Gjykata Supreme konstaton se konform dispozitës së nenit 385. par. 5. të KPPK kur është fjala për vendimin për dënimin, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, *gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore*.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar llojin e dënimit të paraparë për këtë vepër penale gjegjësisht dënim me burgim, lartësia e të cilit është brenda minimumin dhe maksimumit të dënim të cilit ligji e parasheh (ligji e parasheh dënimin me gjobë ose me burgim deri në 6 muaj). Këtë vendim e ka vërtetuar gjykata e shkallës së dytë. Nga kjo rrjedhë se nuk mund të aprovohet pretendimi në kërkesë sepse nuk është shkelur dispozita e nenit 385.par.5.të KPPK.

Në rast se nuk është fjalë për këtë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjykimi është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërliqej me mungesën ose paqartësitë të arsyeve lidhur me vendimin për dënimin, mirëpo, në rastin konkret një pretendim i këtillë në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është paraqitur, por kundërshtohet vetëm mënyra e vlerësimit të rrethanave lehtësuese gjegjësisht mos marrja në konsideratë të rrethanave lehtësuese të cilat më lartë u përshkruan.

Gjykata Supreme konstaton se aktgjykimeve të kundërshtuara nuk i mungon arsyetimi i ligjshëm për vendimin për dënim. Përkundrazi, në pasusin e parafundit të aktgjykimit të shkallës së parë theksohen rrethanat siç janë pranimi i fajësisë, pendimi i të dënuarit, se ka kërkuar falje nga e dëmtuara dhe familja e saj dhe se ka premtuar se veprën nuk do të përsërit dhe këto rrethana i ka vlerësuar si rrethana lehtësuese.

Nuk mund të aprovohen as pretendimet në kërkesë se gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsye ligjore për mos aprovimin e pretendimeve ankimore, sepse ky pretendim nuk ka arsyetim konkret, ndërsa sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i shkallës së dytë është përqendruar në arsyetimin e pretendimeve për vendimin për dënim

dhe në pretendimet ankimore të mbrojtësit të dënuarit, duke dhënë arsye të mjaftueshme për gjetjet e veta. Andaj, as aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Në anën tjetër, nga aktgjykimi i shkallës së parë dhe nga shkresat e lëndës del se i dënuari ka pranuar fajësinë, pranimi i fajësisë është miratuar dhe aktgjykimi nuk ka mundur të ankimohet për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për çka aktgjykimi i shkallës së dytë po ashtu përmban arsye ligjore. Për këtë arsye, janë të pabazuara dhe të pa pranueshme theksimet (të përgjithësuara) në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për atë se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar, se veprimet inkriminuese për të cilat i dënuari është shpallur fajtor nuk paraqesin vepër penale dhe se në dëm të tij është shkelur ligji penal.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar dhe konform nenit 437. të KPPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pml.nr. 224/2016, më 03.10.2016.

Proçesmbajtësi,  
Sherif Krasniqi

Kryetarja e kolegjit,  
Valdete Daka